# Procesverbal: Nr. 1

Mbajtur sot më datë 28.06.2024, në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd.
Pasi u lexua rendi i ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 15 (anëtar)
Miratohet fillimi i mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:

1. P/Vendim "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% periudha Maj 2024".
2. P/Vendim "Për shpërndarjen e një pjese të fondit financiar të MC të vitit 2024 për familjet: e z. Hajdar Kreshka dhe Ramazan Kullolli, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore dhe dhënien e Ndihmës Financiare nga ana e Bashkisë Librazhd.
3. P/Vendim "Për miratimin e dokumentacionit teknik lejor dhe dhënien e Ndihmës Financiare për familjen e z. Ymer Daja banor i fshatit Vehçan Nj Adm Hotolisht. banesa e të cilit ka pësuar ka pësuar fatkeqësi natyrore (rrëshqitje trualli).
4. P/Vendim "Ndihma Financiare".
5. P/Vendim "Për një ndryshim dhe shtesë në V.KB. në nr 108, dt 30.11.2023 "Për miratimin e Paketës Fiskale (taksave dhe tarifave vendore) në Bashkinë Librazhd për vitin 2024".

Nr 2

6. P/vendim "Për miratimin e listës shtesë të familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2024".

7. P/vendim "Miratimin e programit të punës për parandalimin dhe masat që do të merren në mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri.

8. P/vendim "Për vlerësimin me titull Qytetar Nderi z. Arif Lushi dhe Znj. Hatixhe Lushi.

9. Të ndryshme:

1. P/vendim "Për miratimin e marrveshjes bashkëpunimit objekt "Rikostruksioni i rrugës për te kisha.

2. P/vendim "Për një shtesë dhe një ndryshim në v.k.b nr 119 datë 29.12.2023.

3. P/vendim "Për ndëitimin e memorialit për figuren e Hysen Lodës

4. P/vendim "Për hapjen e rrugës auto.

= Fillimi i mbledhjes.

M. Disha "Kam sjellë pranë jush dy p/vendime që kemi fituar nga Këshilli Qarkut, të mi dhe "Përmirësimi i kushteve të banimit. Në fushe Studo do të ndëitojmë një korsi për biçikleta dhe një pendër Ku do ti shërbej turismit.

= Ndryshohet rendi ditës ku si fillim N°3
do të hedhim për miratim dy pikat e të
7 ku si fillim miratojmë ndryshimin e
redit të ditës
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve
15 vota pro.
P/vendimi N°1
"Për miratimin e marrveshjes bashkëpunimit
objektit "Rikonstruksioni i rrugës për te kisha
= Miratohet me të gjitha votat pro 15 vota

P/vendimi N°2
Miratohet me 14 vota pro dhe 1 abstenim.
Miratohet me 14 vota pro dhe 1 apstenim.
Miratohet me 14 vota pro dhe 1 apstenim.
= Fillojmë me rendin e ditës në lidhje me mbledhjen.
P/vendimi N°1 i rendit të ditës:
Ndihma ekonomike 6%.
Çim Doda "Sa familje përfitojnë ndihmën ekonomike
Selime Ozuni "Ndihmën ekonomike e përfitojnë
2026 familje dhe i kemi ndarë sipas kategorisë.
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve 16 vota.
P/vendimi N°2
Pëllumb Zharri "Kemi këto dy familje që janë
prekur në 2019 dhe shpërblimin e parë e kanë
marrë tani marrin pjesën tjetër.

Bledi Koci " Pse jane zvarritur këto N°4.
familje ku kanë fajet që ju ka ndodhur
fatkeqësia.

Falbardha Dafja " Do të ishte mirë që në si
këshillë të kemi të gjithë listën në dispozicion.
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve 16 vota.

Çvendimi N°3

Cim Doda " Mos kemi ndonjë mosmarrveshje me
banorët e fshatit.
P. Zharri " Nuk kemi asnjë rast që të kemi mosmarr-
veshje.
Cim Doda " Kam pasur raste kur punoja në Komunë që
kemi pasur raste mosmarrveshje.
Xhuljeta Borici " Ne nuk jemi kundër për asnjë
familje që ndihmohet. Të vini dhe listën në
ndisporicion që ne të shikojmë që kush përgjidhet.
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve 16 vota

Çvendimi N°4.
Xhuljeta Borici " Në lidhje me këtë rast është vertet
një situat shumë e rëndë. Të rritet nqs është
mundësia nga financa.
Bledi Koci " Ne po shikojmë që Bashkia pagon
qeranë për persona që vinë nga fshati.
Të shikohet me imtësi dhe kjo vlerë të rritet.
A. Hoxha " Kjo kërkesë ka disa kohë që na është
bërë në atë kohë kas është kërkuar.

K. Qurra " Kete jane raste emergjente dhe N°5 këshilli të vendosë që një shifër që ti japim ti vi në ndihmë familjes.

Bledi Koci " Të shikoni këtë familje se kjo shumë nuk i bën punë. Drejtoresha e Financës duhet të dijë që si e ka fondin.

= Miratohet në parim që të rishikohet shuma e dhënë për familjen me 16 vota pro.

Vendimi N° 5

1. Rreshka " Kemi sjellë prane jush ku kemi dy pika në lidhje me ndërtimet e ndryshuar. Kjo është taksa që vjen me ndryshime nga rejë. Kjo u.kb.

2. Bahiti " Të gjitha zonat e dibrazhdit ndryshohet kjo taksë.

Bledi Koci " Të shtoni një taksë në lidhje me parkimin që do të bëhet me mbulesë. Të bëhet me ndryshim në lidhje me ndërtimin dhe të saktësohet. Për shoqërite nga 4 deri në 8.
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve 15 vota.

Vendimi N° 6.

Xhuljeta Borici " Në lidhje me bonusin e qerasë është një gjë e mirë për ko dhe lidhje që po i linë prindërit dhe po vinë në qytet pasi ju paguhet bonusi i qerasë. Të shikohet me më imtësi pasi shumë familje po linë fshatin dhe po vinë në qytet.

N°6

Dorian Hasula " Kemi dy familje në nësta ku kemi dy familje që janë të moshuar dhe ne për t'u ardhur në ndihmë i ndihmojmë me pagesën e perasë.

Zenel Bahiti = Kjo po na bën që fshati po vjen i gjithë në qytet duke shikuar që ju paguhet peraja.

Bledi Koçi " Në nëpër fshatrat po ngel vetëm mosha e tretë, kemi dhe rastin ku burrat shkojnë në Gjermani dhe gruaja dhe fëmijët rrinë në qytet dhe ju paguhet bonusi i perasë.

Veli Terziu " Këto familje jetojnë në qytet apo vinë nga fshati.

= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve 15 votopro

Qëndrimi N°7.

"Për masat e marra për parandalimin e zjarreve dhe programin që do të ndjekim gjatë kësaj periudhe.

Nora " Si çdo vit ne marrim masat për parandalimin e zjarreve kemi në dispozicion dhe një makinë ku rrinë 4 person që të marrin masat për parandalimin e zjarreve.

Cimu Dodo " Mendoj dhe administrata e bashkisë duhet të jetë në dispozicion.

Fatzim Nogu "Kemi marrë masa në lidhje me programin dhe projektin e fituar ku kemi miratuar montuar dhe kamera për të na ardhur sado pak në ndihmë ku ne e shikojmë dhe mund ta parandalojmë në një kohë rekord

Duhet një organizim të mirëfilltë pë të behet e mundur parandalimi i zjarreve. Nº7.

Vendimi Nº 8.
Dhënia e titullit "Qytetar Nderi" Z. Arif Dushi dhe Znj. Hatixhe Dushi.

Xhuljeta Borici " Është një vlerë për ne dhe jam shumë e lumtur që më në fund vlersohen këto dy figura.

Falbardha Qafa " Në fakt ndihem mirë që në këtë rast po bejmë dy figura nga e njejta shtëpi. Si Arifi dhe Hatixhja janë dy figura që vetëm të mira kanë sjellë të mira për Librazhdin.

Falbardha " Kemi këto dy figura që janë nga Lib. dhe çdo gjë që ata kanë bërë kanë lidhje me Libr. dhe i kanë shtuar një i kanë dhënë emër Lib dhe i kanë shtuar një tjetër vlerë.

Cim Dodo " Jam plotësisht dakort për të dy figurat që janë sjellë pranë nesh.

F. Qafa " Unë mendoj që përveç titullit ti ndihmojmë dhe me ndonjë vlerë financiare.

M. Bicaku " Këto janë dy artistë që i kanë dhënë shumë Librazhdit dhe e meritojnë plotësisht.
= Miratohen këto dy figura me të gjitha votat e të pranishmeve 16 vota pro.

Vendim " Berjer e një memoriali për Hysen Toda
= Miratohet me të gjitha votat e të pranishmeve.

Propozim "Për hapje rrugës auto Nº 8.
që i vjen në ndihmë familjes së Alcanit.

Ilir Kuka "Rruga është ekzistuese dhe këta mendojnë
që të bëjnë me letra rrugën.

Xhuljeta Boriçi" Në lidhje me këtë propozim
jam kundër. Duam një info më të saktë.

Ilir Kuka" Jam kundër në lidhje me këtë propozim.

= Mitat Bicaku" Unë mendoj që të kemi dhe më
shumë info dhe të kalojnë në mbledhjen e
radhës.

= Miratohet me të gjithë votat e të pranishmëve
që ky propozim të diskutohet në mbledhjen e
radhës dhe me shumë dokumentacion shtesë.
firmat e banorëve, firma e kryeplakut.

Të ndryshme:
Në lidhje me rrugën e spitalit të ndryshohet
senji ose të hiqen parkingjet. (F. Qafa.)
Xhuljeta Boriçi" Dhe te policia parkingu është bë
shumë keq. Dhe në lidhje me qent kemi
frikë të dalim në qytet. Dhe në fshatra
në lidhje me pastrimin shikoj që nuk pastrohen.